



REPUBLICA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO  
 AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT  
 AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE  
 ANTI-CORRUPTION AGENCY

Dep. \_\_\_\_\_  
 Dep. DPK  
 Dep. \_\_\_\_\_  
 Nr. Fila \_\_\_\_\_  
 Broj stranica 02  
 No. pages \_\_\_\_\_

Nr. Prot \_\_\_\_\_  
 Broj prot \_\_\_\_\_  
 Prot No 03-02/1555/18  
 Data \_\_\_\_\_  
 Datum 01-06-2018  
 Datr \_\_\_\_\_

P. SHITINE



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT**  
**AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE**  
**ANTI - CORRUPTION AGENCY**

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 31.05.2018, mori:

**V E N D I M**

I. Mbyllet rasti me nr. AKK-03-02-3684/17, për z. Halit Isufi, Kryesues i Bordit në Ndërmarrjen Publike "Posta e Kosovës" Sh.A, për shkak se zyrtari i lartë e ka shmangur gjendjen e konfliktit të interesit.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

**A r s y e t i m**

Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në Ushtrimin e Funkcionit Publik për zyrtarin e lartë, z. Halit Isufi, Kryesues i Bordit në Ndërmarrjen Publike "Posta e Kosovës" Sh.A dhe njëkohësisht Anëtar i Kuvendit Komunal në Gjakovë, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin nr. 06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik.

Agjencia kundër Korrupsionit, fillimisht e ka njoftuar zyrtarin e lartë me një shkresë zyrtare për fillimin e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit. Pas pranimi të kësaj shkrese është organizuar një takim me zyrtarin e lartë. Gjatë këtij takimi zyrtari i lartë është njoftuar se krahas ushtrimit të funksionit Kryesues i Bordit në Ndërmarrjen Publike "Posta e Kosovës" Sh.A nuk mund të ushtroj njëkohësisht edhe funksionin Anëtar i Kuvendit Komunal në

Gjakovë sepse është në kundërshtim me Ligjin nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike konkretisht neni 17.2 pika (k).

Agjencia i ka dërguar shkresë paralajmëruese zyrtarit të lartë, me të cilën i është kërkuar të heq dorë nga njëri funksion brenda afatit ligjore, përndryshe Agjencia është e obliguar të veprojë konform neni 22 paragrafi 8 të Ligjit nr.06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit.

Ndërkohë, Agjencia ka pranuar shkresën zyrtare (DPKI.03-02/1506/18) me të cilën dëshmohet se zyrtari i lartë ka dhënë dorëheqje nga funksioni Anëtar i Kuvendit Komunal në Gjakovë.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të neni 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Shaip Havolli  
Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit

